

**Mbi vaksinimin mbrojtës kundër meningokokut C – me vaksinë të konjuguar**

Meningokokët janë baktere (*Neisseria meningitidis*). Ekzistojnë mbi 13 serotipa të ndryshëm. Serotipat A, B, C dhe W janë përgjegjës për epidemitë në mbarë botën. Çdo vit në Gjermani sëmuren rreth 300 deri në 400 njerëz nga infeksioni i rëndë i meningokokut, shumica prej të cilëve fëmijë të vegjël dhe fëmijë shkolle. Rreth 70 për qind e këtyre rasteve janë shkaktuar nga serotipi B, përpara futjes së vaksinimit standard për fëmijët dhe adoleshentët, 20 deri në 30 për qind nga serotipi C, aktualisht janë rreth 16 për qind. Vaksina kundër sëmundjeve të shkaktuara nga serotipi B është e disponueshme që nga fundi i vitit 2013. Por vaksina e trajtuar këtu referohet vetëm kundër meningokokut të serotipit C.

Meningokoku transmetohet nga një individ tek tjetri nëpërmjet frymës (bërthamave pikëz ajrore). Ato mund të shkaktojnë patologji invazive (në të gjithë organizmin e prekur), ku më të shpeshtat janë meningjiti purulent (infeksion i cipës së trurit) dhe sepsis (helmimi i gjakut) me rrezik për jetën. Meningjiti fillon papritmas me temperaturë të lartë, të vjella, dhimbje të forta koke dhe shtangësi të qafës. Gjithashtu, mund të shfaqen edhe konvulsione dhe paraliza. Te fëmijët shumë të vegjël, simptomat janë zakonisht më pak karakteristike. Patologjitë septike janë të ngjashme me meningjitin, por në të shumtën e rasteve karakterizohen nga një ecuri dramatike e sëmundjes. Gjakderdhjet në lëkurë janë tregues të një patologjie të rëndë invazive. Në rastet me avancim septik, vdekja mund të ndodhë brenda disa orësh. Faktor vendimtar në rast se dyshohet për një patologji invazive të meningokokut është dërgimi i menjëhershëm në një pavijon intensiv dhe, kur është e nevojshme, fillimi i trajtimit me antibiotikë para shtrimit në spital. Një trajtim i filluar në kohën e duhur nuk mund ta parandalojë gjithmonë vdekjen ose dëmtimet e përhershme (dëmtime të sistemit nervor qendror, amputime si rezultat i dëmtimeve të rënda të indeve). Ende vdesin rreth 10 për qind e të infektuarve me patogjenin e meningokokut. Kjo përqindje është veçanërisht e lartë tek të infektuarit me patogjenët e serotipit C. Prandaj vaksinimi është masa vendimtare parandaluese.

**Vaksina**

Vaksina përmban pjesë të membranës bakteriale të patogjenit (oligosakaride / polisakaride). Ajo mbron vetëm ndaj infektimit me patogjenë të meningokokut të serotipit C dhe mund të jepet që nga mosha 2-muajshe. Foshnjat e rrezikuara në vitin e parë të jetës, në varësi të vaksinës së përdorur dhe moshës së tyre, marrin 1 ose 2 vaksina; fëmijët mbi 1 vjeç, adoleshentët dhe të rriturit vaksinohen 1 herë. Nëse vaksinimi primar ka filluar në vitin e parë të jetës, në vitin e dytë të jetës rekomandohet një dozë përforcuese.

Vaksina injektohet në muskul (injeksion intramuskulor). Mjeku juaj mund t'ju informojë për fillimin dhe kohëzgjatjen e mbrojtjes nga vaksinimi. Referuar studimeve të deritanishme, nuk jepet asnjë rekomandim për dozë përforcuese (shih përjashtimet e mësipërme).

Vaksinimi kundër meningokokut C mund të bëhet njëkohësisht me vaksina të dyta (të tjera) të rekomanduara, por në vende të ndryshme (p.sh. kofsha e djathtë dhe e majtë, krahu i djathtë dhe i majtë); toleranca dhe efikasiteti nuk ndikohen negativisht nga vaksinimi në të njëjtën kohë me vaksina të tjera. Mjeku juaj mund t'ju informojë për përjashtimet nga ky rregull.

**Kush duhet të vaksinohet?**

Në kuadër të kalendarit të vaksinave, vaksinimi kundër meningokokut C rekomandohet për të gjithë fëmijët në vitin e parë dhe të 2-të të jetës, me 1 dozë vaksine. Komiteti i Përhershëm i Vaksinimit (STIKO) thekson se vaksinat që nuk janë kryer në kohën e rekomanduar mund të kryhen deri në moshën 18 vjeç.

Në parim, nëse vaksinimi dëshirohet ose rekomandohet nga mjeku, mund të vaksinohen të gjithë fëmijët e moshës mbi 2 muaj, adoleshentët dhe të rriturit. STIKO rekomandon vaksinimin sidomos për individët me rrezik të lartë infeksioni apo komplikimesh. Veçanërisht të rrezikuar për shëndetin janë individët me anomali të imunitetit ose të cilëve u mungon ose nuk u funksionon shpretka. Këta individë me patologji bazë duhet të marrin një vaksinë të katërfishtë që i mbron edhe nga grupet e tjera të meningokokut - A, C, W dhe Y dhe, nëse është nevoja, të vaksinohen edhe kundër meningokokut B. Edhe personeli i rrezikuar i laboratorit duhet të vaksinohet kundër këtyre grupeve të meningokokut.

Personat me kontakt të afërt deri tani të pavaksinuar, krahas trajtimit me kemoprofilaksi (antibiotik), duhet edhe të vaksinohen sa më shpejt të jetë e mundur. Në qoftë se në Gjermani ose në institucionet arsimore ndodhin shpesh raste infektimi nga meningokoku C, autoritetet shëndetësore, sipas nevojës, duhet të publikojnë një thirrje për vaksinim për të parandaluar përhapjen e sëmundjes.

Duhet të vaksinohen nxënësit dhe studentët me qëndrim më të gjatë në vendet ku rekomandohet vaksinimi kundër tipit C ose që i përkasin grupmohës për të cilën rekomandohet vaksinimi. Kjo vlen edhe kur ata udhëtojnë në vendet për të cilat autoritetet shëndetësore, në rast epidemish lokale, kanë rekomanduar vaksinimin e kufizuar.

Gjatë udhëtimeve në zona të rrezikuara nga epidemia e meningokokut dhe në rastin e kontaktit të afërt me banorët vendas, rekomandohet dhe këshillohet vaksinimi me vaksinën e katërfishtë (A, C, W, Y). Kjo p.sh. vlen për pelegrinazhet (Haxh, Umra) në Arabinë Saudite apo për udhëtime në "rripin e meningjtit" në Afrikë.

**Kush nuk duhet të vaksinohet?**

Personat që vuajnë nga një sëmundjeje akute me temperaturë që ka nevojë për mjekim nuk duhet të vaksinohen. Gjithashtu, nuk duhet të vaksinohen personat që vuajnë nga mbindjeshmëria ndaj ndonjërit prej përbërësve të vaksinës.

Te gratë shtatzëna duhet të peshohen me shumë kujdes dobitë dhe rreziqet e vaksinimit kundër meningokokut C. Megjithatë, nuk ka dëshmi për efekte anësore të vaksinimit gjatë shtatzënisë. Për pyetje të mëtejshme, këshillohuni me mjekun e vaksinimit.

**Sjellja pas vaksinimit**

I vaksinuari nuk ka nevojë për pushim të veçantë; megjithatë për 3 ditë pas vaksinimit ai duhet të shmangë sforcimet fizike. Personat që priren të kenë reaksione kardiovaskulare apo tek të cilët janë konstatuar alergji të tipit të menjëhershëm, para vaksinimit duhet ta njoftojnë mjekun në lidhje me këtë.

**Reaksione të mundshme lokale dhe të përgjithshme pas vaksinimit**

Pas vaksinimit, përveç synimit të rritjes së imunitetit dhe në këtë mënyrë mbrojtjes nga sëmundja, shumë shpesh ( $\geq 10$  për qind) në vendin e injeksionit mund shfaqen skuqje, ndjeshmëri kur ushtrohet forcë ose ënjtje me dhimbje. Ky reagim është tregues i përballjes normale të trupit me vaksinën dhe ndodh kryesisht brenda 2 deri në 3 ditëve dhe rrallë zgjat më shumë. Rrallë këto reaksione lokale

janë më të forta, duke sjellë kufizim të lëvizjes. Gjithashtu brenda 1 deri në 3 ditëve, rrallë edhe më gjatë, në 1 deri në  $\geq 10$  për qind të të vaksinuarve mund të shfaqen edhe simptoma të përgjithshme si rritje e temperaturës deri në  $38^{\circ}\text{C}$  (rrallë deri në  $39,5^{\circ}\text{C}$ ), plogështi, gjumë jo i qetë ose simptoma gastrointestinale (p.sh. të përziera, të vjella, diarre); te fëmijët mund të shfaqet nervozizëm. Gjithashtu mund të shfaqen dhimbje koke, si dhe dhimbje muskujsh dhe kyçesh apo humbje ndjeshmërie. Zakonisht këto reaksione janë të përkohshme dhe largohen shpejt dhe pa pasoja.

#### **A janë të mundshme komplikacionet nga vaksinimi?**

Komplikacionet nga vaksinimi janë pasoja shumë të rralla të shkaktuara nga vaksinimi, të cilat shkojnë përtej një reaksioni normal dhe që e rëndojnë dukshëm gjendjen shëndetësore të të vaksinuarit. Shumë rrallë mund të ndodhë që pas vaksinimit me vaksinën e konjuguar të meningokokut C të shfaqen reaksione alergjike të lëkurës (p.sh. shpërthim në lëkurë (rash), kruajtje, urtikarie) ose të rrugëve të frymëmarrjes, të cilat në raste të veçanta mund të arrijnë deri në shok. Në raste të veçanta, në lidhje me një rritje të temperaturës te foshnja apo fëmija i vogël, u vu re një konvulsion febril, i cili zakonisht largohet pa pasoja; po në raste të veçanta, në të njëjtën kohë me vaksinën, janë raportuar gjendje të shkurtra shoku me mosreagim dhe plogështi të muskujve, të cilat janë sprapsur shpejt dhe pa pasoja.

#### **Këshillimi për efektet e mundshme anësore me mjekun e vaksinimit**

Përveç kësaj fletëpalosjeje, mjeku juaj ju ofron një bisedë informuese.

Nëse pas një vaksinimi shfaqen simptoma që i tejkalojnë reaksionet e përkohshme lokale dhe të përgjithshme të sipërpërmendura, mjeku i vaksinimit është gjithmonë në dispozicionin tuaj për këshillim.

Mund të kontaktoni me mjekun e vaksinimit:

#### **Deklaratë për mosmbajtje përgjegjësie**

Përkthimi i origjinalit të fletës informuese (publikuar në: 4/2016) është kryer me lejen e "Deutsches Grünes Kreuz e.V. (Kryqi i Gjelbër Gjerman)" me kërkesë të Institutit "Robert Koch". Teksti në gjuhën gjermane ka përparësi. Nuk mund të mbahet asnjë përgjegjësi për gabime të mundshme në përkthim, e aq më pak për aktualitetin e përkthimit në fjalë në raste të rishikimeve të mëvonshme të materialit në gjuhën gjermane.

**Emri** \_\_\_\_\_

Name

**Vaksinimi mbrojtës kundër sëmundjeve të meningokokut C – me vaksinë të konjuguar***Schutzimpfung gegen Meningokokken C – mit Konjugatimpfstoff*

Bashkëlidhur gjeni një fletëpalosje mbi kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër sëmundjeve të meningokokut C me vaksinë të konjuguar. Aty përfshihen të dhënat kryesore mbi sëmundjet që shmangen nëpërmjet vaksinimit, mbi vaksinën, vaksinimin, si dhe reaksionet dhe komplikacionet e mundshme të vaksinimit.

*Anliegend erhalten Sie ein Merkblatt über die Durchführung der Schutzimpfung gegen Meningokokken C. Darin sind die wesentlichen Angaben über die durch die Impfung vermeidbaren Krankheiten, den Impfstoff, die Impfung, das Verhalten nach der Impfung sowie über Impfreaktionen und mögliche Impfkomplicationen enthalten.*

Para kryerjes së vaksinimit kërkohen të dhënat shtesë si më poshtë:

*Vor der Durchführung der Impfung wird zusätzlich um folgende Angaben gebeten:*

1. A gëzon shëndet të plotë personi që do të vaksinohet në momentin e vaksinimit?

*Ist der Impfling gegenwärtig gesund?*

Po (Ja)

Jo (Nein)

2. A vuan nga ndonjë alergji personi që do të vaksinohet?

*Ist bei dem Impfling eine Allergie bekannt?*

Po (Ja)

Jo (Nein)

nëse po, nga cila? \_\_\_\_\_

*wenn ja, welche*

3. A janë shfaqur te personi që do të vaksinohet shenja alergjike, temperaturë e lartë apo ndonjë reaktion i pazakontë pas një vaksinimi të mëparshëm?

*Traten bei dem Impfling nach einer früheren Impfung allergische Erscheinungen, hohes Fieber oder andere ungewöhnliche Reaktionen auf?*

Po (Ja)

Jo (Nein)

Nëse dëshironi të dini më shumë rreth vaksinimit mbrojtës kundër sëmundjeve të meningokokut C – me vaksinë të konjuguar, pyesni mjekun e vaksinimit!

*Falls Sie noch mehr über die Schutzimpfung gegen Meningokokken C – mit Konjugatimpfstoff – wissen wollen, fragen Sie den Impfarzt!*

Në takimin për vaksinimin, ju lutemi merrni me vete kartelën e vaksinimit!

*Zum Impftermin bringen Sie bitte das Impfbuch mit!*

**Deklaratë miratimi***Einverständniserklärung***për kryerjen e vaksinimit mbrojtës kundër sëmundjeve të meningokokut C – me vaksinë të konjuguar***zur Durchführung der Schutzimpfung gegen Meningokokken C – mit Konjugatimpfstoff*

Emri i personit që do të vaksinohet \_\_\_\_\_

*Name des Impflings*

Lindur më \_\_\_\_\_

*geb. am*

Unë u njoha me përmbajtjen e fletëpalosjes dhe në një bisedë me mjekun/mjekën time u informova në mënyrë të detajuar mbi vaksinimin.

*Ich habe den Inhalt des Merkblatts zur Kenntnis genommen und bin von meinem Arzt/meiner Ärztin im Gespräch ausführlich über die Impfung aufgeklärt worden.*

 Nuk kam pyetje të tjera.*Ich habe keine weiteren Fragen.* E pranoj vaksinimin e propozuar kundër sëmundjeve të meningokokut C me vaksinë të konjuguar.*Ich willige in die vorgeschlagene Impfung gegen Meningokokken C ein.* E refuzoj vaksinimin. Jam vënë në dijeni për anët negative të mundshme të refuzimit të vaksinimit.*Ich lehne die Impfung ab. Über mögliche Nachteile der Ablehnung dieser Impfung wurde ich informiert.*

Shënime \_\_\_\_\_

*Vermerke*

Vendi, data \_\_\_\_\_

*Ort, Datum*\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i personit që do të vaksinohet  
ose i kujdestarit të tij*Unterschrift des Impflings bzw. des Sorgeberechtigten*\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i mjekut/mjekes*Unterschrift des Arztes/der Ärztin*